



Në bazë të nenit 160 paragrafi (3) të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 82/18), dhe neni 22 paragrafi (1) pika 1, neni 23, neni 24, Neni 25, neni 26 dhe neni 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/2016, 120/18 dhe 110/19) Fakulteti i shkencave islame – Shkup shpall:

KONKURS PUBLIK

Për punësim të dy (2) personave në kohë të pacaktuar edhe atë:

1. Sigurim (1) përmbaues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotëson kushtet e mëposhtme:

- Arsimit të mesëm;
- Me përvojë pune së paku 15 vite

Shuma neto e pagës bazë arrin 23.000 den.

2. MJESHTËR SHTËPIAK (1) përmbaues

- Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotëson kushtet e mëposhtme:
- Arsimit fillor ose Arsimit të mesëm;
- Me ose pa përvojë pune në profesion

Shuma neto e pagës bazë arrin 23.000 den.

Kandidatët përveç kushteve të lartëpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- të jenë të moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim nga gjykata se nuk ka të shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar. Kandidatët së bashku me fletëaplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Dëshmi e shëndetit të përgjithshëm për vendin e punës –Vërtetim mjekësor
3. Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
4. Çertifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimit në përputhje me kërkesat në konkurs;



5. Dëshmi mbi përvojën e punës

Orari i punës: 40 orë në javë, prej 08:30 deri 16:30 gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premten. Me kandidatin e përzgjedhur do të firmoset kontrata e punës me kohë zgjatje të pacaktuar.

Afati për dorëzimin e fletëaplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e shpalljes së konkursit. Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 90 ditëve dhe më shumë se 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 120 ditëve, pas afatit për aplikim.

Fletëaplikimet me dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në Fakultetin e shkencave islame- Shkup f. Kondovë për vendin e punës numër (një) 1 dhe dy (2).

Fletë aplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Kontakt :

Tel. zyrja e dekanit : + 389 2 2057270

E mail : sekretari@fshi.edu.mk

Fakulteti i Shkencave Islame -Shkup